



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KONISPOL

KOORDINATOR PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1486 Prot

Konispol më 17.10.2025

Lënda: Kthim përgjigje

QENDRËS KONSUMATORI SHQIPËTAR

Durrës

Në përgjigje të shkresës tuaj të datës 10.10.2025 e cila kërkon informacion në lidhje me Zyrën e Mbrojtjes së Konsumatorit në Bashkinë Konispol ju informojmë si më poshtë:

-Zyra e mbrojtjes së konsumatorit në bashkinë tonë është pjesë e Drejtorisë së Bujqësisë, Blegtorisë dhe Menaxhimit Pyjor, në sektorin e bujqësisë e cila përbëhet nga dy punonjës si Specialist të Mbrojtjes së Konsumatorit, strukturë e cila është miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 44, datë 27.11.2024, "Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Konispol për vitin 2025".

-Detyrat dhe Përgjegjësitë e Punonjësit të ZMK

1. Kontrollon të gjitha produktet me origjinë shtazore dhe të detit që tregtohen në qytet, duke verifikuar cilësinë dhe pajisjen e tyre me dokumentacionin përkatës.
2. Kërkon ndihmën e Policisë Bashkiake për mbylljen e aktivitetit kur konstaton shkelje ligjore nga subjektet që tregtojnë produkte shtazore apo të detit.
3. Kontrollon kafshët para therjes, mishin gjatë dhe pas therjes, dhe pas kryerjes së ekspertizës veterinare e pajis me certifikatë dhe bën vulosjen përkatëse.
4. Kontrollon zbatimin e kushteve sanitario-veterinare në objektet ku prodhohen, përpunohen, konservohen, transportohen dhe tregtohen ushqimet me origjinë shtazore.
5. Kujdeset për dezinfektimin e ambienteve të therjes dhe tregtimit të mishit të freskët.
6. Ushtron kontrole të vazhdueshme organoleptike mbi produktet ushqimore shtazore; kontrollon nënproduktet e mishit (si sallamet) dhe i certifikon ato.

7. Bashkërendon punën me Shërbimin Veterinar të Qarkut dhe me njësitë e tjera vendore për çështje që lidhen me ruajtjen e shëndetit të banorëve.
8. Merr masa mbrojtëse, profilaktike dhe karantine në territorin e bashkisë, duke zbatuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
9. Bllokon dhe konfiskon organet e kafshëve të prekura nga sëmundjet infektive ose parazitare dhe mban dokumentacionin përkatës për këto raste.
10. Kontrollon peshkun në njësitë e tregtimit të tij.
11. Kontrollon pikat kryesore të shpërndarjes së bulmetit.
12. Raporton periodikisht për çdo problem të konstatuar dhe përgjigjet për kryerjen e detyrave të sektorit para eprorit direkt.

-Të dy punonjësit kanë arsimin e Lartë në Master Professional “ Cilësia dhe Siguria Ushqimore” dhe Mjekësi Veterinare. Punonjësit kanë kryer trajnimet e detyruara nga ASPA .

Bashkia jonë në bashkëpunim me drejtorine e AKU –së kemi realizuar herë pas here kontrole .

Ankesat e ardhura pranë bashkisë tonë janë trajtuar në bashkëpunim me policinë bashkiake dhe është arritur zgjidhje.

Duke ju falenderuar!

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Marinela Harlia

